# DËSHMI ARKIVI

**A-473530**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Lëviz tonelata me kokainë / Ky është "Pitbulli" që del në dosje me Salvadore Aliun (EMRI) |
| ADRESA | `https://lajmifundit.al/leviz-tonelata-me-kokaine-ky-eshte-sokol-bibaj-pitbulli-qe-del-ne-dosje-me-salvadore-aliun-i1338906` |
| BURIMI | lajmifundit.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 11:09:49 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 12:56:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `62364cf915c8a8c4d3ec40f1be74f0e00341ba59fc2748d1cb2be8147439b4ca` |
| TEKSTI | `b8a4ed909387b89e03d008bcb21bca5a953ff1deef57393e758404cad45741ad` |
| PAMJA | `26557b620fd9ccccae9287aad042d46bcdc1d403dc488339f9c2d1b002184626` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f880ae317f304014abcc328752468103460e016ca99c266551783c4b6a43ddd5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c13049b8c76e790ba04e601561e0fbdfe5bb40424b3beb99843a4ea880b55b30` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f880ae317f304014abcc328752468103460e016ca99c266551783c4b6a43ddd5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Lëviz tonelata me kokainë / Ky është "Pitbulli" që del në dosje me Salvadore Aliun (EMRI)

LAJMIFUNDIT / 27 SEPTEMBER 2026, 12:56

Shperndaje

AKTUALITET




Sokol Bibaj, i njohur me nofkat "Gus", "Gusti" dhe "Pitbull", është një prej personave të shpallur në kërkim në kuadër të hetimeve të SPAK për një rrjet të dyshuar të trafikut ndërkombëtar të kokainës nga Amerika Latine drejt Europës.

Ndaj Bibajt, Gjykata e Posaçme ka caktuar masën e sigurisë "arrest në burg". Ai dyshohet për trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike, pastrim parash dhe pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal

Emri i tij shfaqet në të njëjtën dosje me disa persona të tjerë nën hetim, mes të cilëve Shpëtim Aliu, i njohur edhe si Salvadore, Dritan Gjika, Denis Matoshi alias Eldi Dizdari, Nikoll Bibaj, Isa Aliu, Florjan Musaj, Naldi Yzeiraj, Armando Pacani dhe Oklid Aliu.

Sipas materialeve hetimore, SPAK dyshon se Sokol Bibaj kishte një rol të rëndësishëm në skemën e trafikut, duke drejtuar një grup që siguronte kokainë përmes Shpëtim Aliut. Ky i fundit u arrestua së fundmi në Rusi, pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, ndërsa autoritetet shqiptare presin ekstradimin e tij.

Një pjesë e provave mbi të cilat mbështeten hetimet lidhet me komunikimet e zhvilluara në platformën e koduar Sky ECC. Sipas dosjes, këto komunikime kanë ndihmuar hetuesit të dokumentojnë lidhjet mes personave të dyshuar, ndërsa emri i Sokol Bibajt shfaqet në disa episode që lidhen me ngarkesa të dyshuara kokaine.

MOTI NE TIRANE
Tirana, Albania

POLITIKË
Kryeministri Rama mbërrin nga New York në orën 13:00 / Burimet qeveritare tregojnë çfarë pritet të deklarojë nga salla VIP në Rinas

POLITIKË
Braçe bën pazarin e së dielës dhe alarmohet për çmimet dhe kursin e këmbimit: Abuzim që të lë pa mend

TRENDING

Destinacioni sekret: Wizz Air sjell në TIA 150 influencues dhe gazetarë për të zbuluar Shqipërinë

Kryeministri Rama në New York: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, dëshmi e transformimit të Shqipërisë

Në hetime përmendet gjithashtu vëllai i tij, Nikoll Bibaj, i njohur me nofkat "Buci" dhe "Ujku".

Një prej episodeve të përfshira në materialet hetimore lidhet me një komunikim zanor të datës 31 maj 2020. Sipas dosjes, Sokol Bibaj i tregonte të vëllait se autoritetet kishin dërguar fotografinë e tij në Shkup dhe kishin arritur ta identifikonin. Në bisedë ai fliste gjithashtu për rrethanat e një ndalimi të mëparshëm dhe pretendonte se informacione për të ishin dhënë nga një ish-efektiv i strukturave kundër krimit të organizuar.

**LEXONI GJITHASHTU**



**I krijuar nga shqiptari.../Miliarderi Mark Zuckerberg zbulon orën që nuk e heq nga dora!**



**Vdekja e Giorgos Mazonakis, zbulohet mesazhi i FUNDIT për trajtimin dhe pagesën...**



**Operacioni "Shkolla të Pastra"/ Detaje të reja si u kamufluan 13 agjentë si nxënës shkolle**

Hetuesit kanë veçuar pesë episode kryesore të dyshuara të trafikut të narkotikëve që lidhen me rrjetin nën hetim. Sipas SPAK, grupet drejtoheshin nga persona mes të cilëve Eldi Dizdari, Dritan Gjika dhe Armando Pacani, ndërsa Shpëtim Aliu dyshohet se kishte një rol kryesor në furnizimin me lëndë narkotike.

Hetimi nuk është përqendruar vetëm te trafiku i kokainës, por edhe te destinacioni i parave që dyshohet se janë gjeneruar nga aktiviteti kriminal. Prokuroria e Posaçme pretendon se një pjesë e këtyre të ardhurave është sjellë në Shqipëri në formë cash, duke shmangur sistemin bankar.

Paratë dyshohet se më pas janë përdorur për investime në pasuri të paluajtshme dhe në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, përfshirë kompani tregtare, ndërtim, hoteleri dhe konsulencë. Hetimet për të dokumentuar aktivitetin dhe rolin e personave të përfshirë vijojnë.

POLITIKË

**Rama kthehet sot nga SHBA-të/ Mban konferencë në Rinas, do të flasë për arrestin e Vlora Hysenit?**

POLITIKË

**Tragjedia me 6 viktima në Athinë, reagon Ministria e Jashtme e Shqipërisë: Jemi thellësisht të pikëlluar**

## ME TE LEXUARAT

"Zbrazi karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e...

Lexo lajmin e plote

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

Lexo lajmin e plote

Skandali "Xhaka" merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

Lexo lajmin e plote

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!...

Lexo lajmin e plote

## ME TE LEXUARAT

"Zbrazi karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi" – Mediat italiane: Jeta e "dyfishtë" e Gjovalin Lazrit

Lexo lajmin e plote

## NA SHKRUAJ

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

Kliko për më shumë informacion

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026
Lexo lajmin e plote

Skandali “Xhaka” merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë
Lexo lajmin e plote

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!
Lexo lajmin e plote

"Askush nuk është mbi ligjin"/ Rama shkarkon menjëherë Vlora Hysenin: Pas kthimit në Tiranë zgjedh drejtuesin e ri të SHISH
Lexo lajmin e plote

Sekuestrohet hoteli “Central Park Premium” në Ksamil, u ndërtua pa leje! Ja kujt i përket
Lexo lajmin e plote

"Ka gjëra që edhe ne që i dimë nuk flasim dot"/ Artan Hoxha: Ka fakte tronditëse për Ballukun, gropa u hap
Lexo lajmin e plote

LAJMI FUNDIT

KUSH JEMI   KONTAKT REDAKSINË   TE DHENAT PERSONALE   COOKIES

LajmiFundit merr pjesë në programe të ndryshme marketingu ku mund të përfitojë komisione për produktet e zgjedhura në artikujt e publikuar.

Created & Monetized by Mediadesk

REGJISTROHU NË NEWSLETTER

OK

Ju do te merrni njoftime periodike me Lajmet e Fundit.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.